

**URDHËR**  
**Nr. 425, datë 16.7.2020**

**PËR MIRATIMIN E UDHËZUESIT TË INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK**  
**“MBI PËRDORIMIN E BARRIERAVE MBROJTËSE/MASKAVE NË AMBIENTE**  
**TË MBYLLURA PUBLIKE DHE TREGTARE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 23, të nenit 3, të aktit normativ nr. 3, datë 15.3.2020, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni COVID-19,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e udhëzuesit të Institutit të Shëndetit Publik, “Mbi përdorimin e barrierave mbrojtëse/maskave në ambiente të mbyllura publike dhe tregtare”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor dhe të gjitha institucionet përgjegjëse, sipas përcaktimeve në pikën 23, të nenit 3, të aktit normativ nr. 3, datë 15.3.2020, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE**  
**MBROJTJES SOCIALE**  
**Ogerta Manastirliu**

**UDHËZUES I INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK**  
**“MBI PËRDORIMIN E BARRIERAVE MBROJTËSE/MASKAVE NË AMBIENTET E**  
**MBYLLURA PUBLIKE DHE TREGTARE”**

**Qëllimi**

Qëllimi i këtij udhëzuesi është përcaktimi i vendeve ku do të përdoren barrierat mbrojtëse (maskat), si edhe i kriterëve të përshtatshmërisë së tyre dhe mënyrës së përdorimit në ambiente të mbyllura publike dhe tregtare, nga individët në komunitet, me qëllim zvogëlimin të transmetimit të mundshëm të COVID-19. Për sa më sipër:

1. Barriera mbrojtëse/maska duhet të përdoret nga të gjithë individët me përjashtim të fëmijëve deri në 10 vjeç.

2. Barriera mbrojtëse/maska nuk duhet të hiqet apo të ulet poshtë zonës së rekomanduar kur bashkëbisedohet.

3. Përdorimi i barrierës mbrojtëse/maskës në ambientet e mbyllura duhet të konsiderohet si masë plotësuese dhe jo si zëvendësim i masave kryesore parandaluese që rekomandohen për të zvogëluar transmetimin në komunitet, përfshirë distancën fizike, qëndrimin në shtëpi, kur jeni të sëmurë, respektimin e etiketës respiratore, higjienën e përpiktë të duarve dhe shmangien e prekjës së fytyrës, hundës, syve dhe gojës.

**Ambientet ku është i detyrueshëm përdorimi i barrierës mbrojtëse/maskës:**

“Ambient i mbyllur” është:

a) një ambient që ka tavan ose çati, dyer, dritare ose rrugëkalime që mund të jenë të hapura apo të mbyllura dhe është i kufizuar plotësisht me mure dhe çdo lloj materiali tjetër të përherëshëm ose të përkohshëm;

b) një ambient, që ka tavan ose çati, dyer, dritare ose rrugëkalime që mund të jenë të hapura apo të mbyllura dhe është i kufizuar me mure të përhershme ose të përkohshme, muret e të cilit kanë hapje të përhershme, që nuk mund të hapen apo të mbyllen, me sipërfaqe më pak se 50 përqind e sipërfaqes së përgjithshme të mureve.

Ambientet e mbyllura publike dhe tregtare ku është e detyrueshme mbajtja e barrierës mbrojtëse/maskës përfshijnë:

- të gjitha ambientet e mbyllura;
- të gjithë administratën publike dhe jopublike;
- transportin publik;
- zyra, banka, farmaci;
- të gjitha qendrat tregtare, dyqanet;
- të gjitha supermakatat, tregjet dhe njësitë e shërbimit.

#### **Përcaktimi i barrierave mbrojtëse/maskave jomjekësore**

Maska jomjekësore për fytyrën/barriera mbrojtëse (ose maskat e komunitetit) përfshijnë forma të ndryshme nga ato të bëra vetë ose maska komerciale të realizuara prej pëlhure, tekstile ose materiale të tjera.

#### **Përdorimi i saktë i barrierës mbrojtëse/maskës**

- Pastroni duart me sapun dhe ujë ose dezinfektues duarsh me bazë alkooli përpara se të vendosni dhe të hiqni barrierën mbrojtëse/maskën e fytyrës.

- Barriera mbrojtëse/maska e fytyrës duhet të mbulojë plotësisht fytyrën nga ura e hundës deri poshtë në mjekër.

- Evitoni prekjen e barrierës mbrojtëse/maskës gjatë kohës që e mbani të veshur.

- Kur hiqni barrierën mbrojtëse/maskën e fytyrës, hiqeni atë nga pas, duke shmangur prekjen e përparme të saj.

- Hidhni barrierën mbrojtëse/maskën e fytyrës në mënyrë të sigurt në koshin e mbetjeve.

- Lani duart ose aplikoni dezinfektuesin me bazë alkooli menjëherë pasi të hiqni barrierën mbrojtëse/maskën e fytyrës.

- Barriera mbrojtëse/maska jomjekësore, prej tekstili e larë, e ripërdorshme duhet të lahet sa më shpejt që të jetë e mundur pas çdo përdorimi, duke përdorur larës të zakonshëm në 60°C.

- Maska është personale dhe nuk ndahet me asnjë person tjetër.